

**AKTI I THEMELIMIT
DHE
STATUTI I SHOQERISE
Compelling Works SHPK**

Në baze të ligjit 9901, datë 15.11.2024, "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, Ligjet nr. 9723, dt. 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar, si dhe në përputhje me Kushtetutën dhe Kodin Civil në Fuqi të Republikës së Shqipërisë, me vullnetin e tyre të lirë të shprehur dhe me nënshkrimin e Akt Themelimit & Statutit, sot më date **12/12/2024** Ortakët e **Shoqërisë**, shpallin si më poshtë vijon:

**NENI 1
FORMIMI I SHOQERISE**

Formimi i shoqërisë së emërtuar "**Compelling Works SHPK.**" (që më poshtë do të quhet "Shoqëria") me ortakët:

- Marina Parllaku**, shtetas(e) shqiptar(e), lindur në Leskovik, Kolonjë më datë 31/03/1983, identifikuar me dokumentin kartë identiteti nr. 032615074, me numër personal I35331066W, me adresë Rruga Asim Vokshi, Nd.14, H.52, Ap.36, Njësia Administrative Nr. 9, 1058, Tiranë, Shqipëri;
- Simon Peter Ndira**, shtetas gjerman, lindur në Nsambya, më datë 02/02/1974, identifikuar me dokumentin pasaportë nr. C47LY2RLW, me adresë Mtawa Road 11, Namiwawa, Blantyre, Malawi;

**NENI 2
SELIA E SHOQERISE**

- 2.1 Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresen:** Rruga Asim Vokshi, Nd.14, H.52, Ap.36, Njësia Administrative Nr. 9, 1058, Tiranë, Shqipëri.
- 2.2 Gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj Shoqëria mund të hapë degë dhe zyra përfaqësimi kudo në territorin e Republikës së Shqipërisë.**

**NENI 3
KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE EKONOMIKE**

- 3.1** Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është e pakufizuar.

**NENI 4
OBJEKTI PËVEPRIMTARISE SE SHOQERISE**

4.1 Objekti i Shoqërisë do të jetë kryerja e aktivitetit në fushën e konsulencës për promovimin e shëndetit, mirëqenies dhe zhvillimit përmes transformimit digjital dhe kërkimeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi e licencat e dhëna nga autoritetet e caktuara me ligji.

4.2 Pa kufizuar objektin e aktivitetit si më sipër, Shoqëria do të ofrojë:

- a. Konsulenca për Zhvillim: Compelling Works ofron shërbime konsulencë në lidhje me zhvillimin e sistemeve. Ato fokusohen në zgjidhje praktike dixhitale për të përmirësuar shëndetin, mirëqenien dhe zhvillimin në përgjithësi.
- b. Zgjidhje për Shëndetin Dixhital (Digital Health): Compelling Works specializohet në identifikimin dhe zbatimin e zgjidhjeve për shëndetin dixhital, në punojmë me organizata dhe institucione shëndetësore për të zbatuar qasje të orientuara nga teknologjia që forcojnë sistemet shëndetësore.
- c. Mbështetje për Projekte: Compelling Works mbështet projekte të ndryshme në shumë vende. Mbështetja përfshin ndihmë teknike ose ekspertizë.
- d. Rezultate Pozitive për Shëndetin: Compelling Works synon të përmirësojë rezultatet shëndetësore duke përdorur mjete dixhitale. Objekti i aktivitetit gjithashtu mund të përfshijë projektimin, zbatimin dhe vlerësimin e ndërhyrjeve të lidhura me shëndetin.
- e. Bashkëpunim me institucionet në fushën e shëndetësisë: Qëllimi është të ndihmojmë entitetet në fushën e shëndetësisë të përshtaten me ndryshimet dixhitale në mënyrë efikase, duke siguruar shërbime shëndetësore të efektshme.
- f. Transformim digjital: Compelling Works mbështet kompani të tjera për të shfrytëzuar teknologjinë digitale për të rritur vlerën e klientëve.
- g. Punë kërkimore: Compelling Works kontribuon në njoħuri dhe inovacion nëpermjet punëve kërkimore (research).

4.3 Shoqëria mund të themelojë apo zoterojë pjesemarrje, të bashkëpunojë, të lidhë marrëveshje "joint – venture" a marrëveshje të ngjashme me shoqëri që kanë objekt të ngjashëm apo të lidhur me objektin e saj.

NENI 5 REGJIMI JURIDIK I SHOQERISE

- 5.1 Kjo shoqëri mund të ndryshojë emërtimin e saj, vendqëndrimin, të shtojë ortakë, të rrisë kapitalin sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve dhe në përputhje me dispozitat e legjislacionit tregtar e atij civil në fuqi.
- 5.2 Shoqëria drejtobet sipas parimeve të ekonomisë së tregut dhe ka qëllime fitimi.
- 5.3 Shoqëria është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (Sh.P.K.). Veprimitaria e saj i nënshtrohet dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit si dhe dispozitave të legjislacionit tregtar e atij civil në fuqi.
- 5.4 Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, Shoqëria mundet që të ndryshojë regjimin juridik të saj në përputhje me dispozitat ligjore që do të jenë në fuqi si dhe në përputhje të plotë me dispozitat e Aktit të Themelimit dhe të Statutit të saj, duke bërë edhe përshtatjen e tyre sipas ndryshimeve përkatëse.
- 5.5 Shoqëria gëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Shoqëria ka vulën e saj.

NENI 6 KAPITALI I SHOQERISE

- 6.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë do të jetë 120,000 Lekë, (njëqind e njëzet mijë) Leke. Zotërueshit e kapitalit do të jene sipas tabelës më poshtë:

	ORTAKET	PERQINDJA E KUOTAVE	KUOTAT	VLERA në LEKE
1	Marina Parllaku	66.67%	1	80,000 Leke
2	Simon Peter Ndira	33.33%	1	40,000 Leke

- 6.2 Kapitali themeltar fillestar mund të shtohet ose të pakësohet (por jo nën vlerën e kapitalit themeltar fillestar).
- 6.3 Ortakët janë përgjegjës kundrejt palëve të treta për humbjet që pëson Shoqëria, deri në shumën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar.
- 6.4 Kapitali themeltar mund të zmadhohet ose të zgjedhohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore.

NENI 7
KUOTAT
TE DREJTAT DHE DETYRIMET E LIDHURA

- 7.1 Çdo kuotë i jep zotëruesit të drejtën e një vote.
- 7.2 Pronësia mbi kuotat do të regjistrohet në regjistrin e ortakëve që do të mbahet në selinë e Shoqërisë nën përgjegjësinë e Administratorëve (“Regjistri i Ortakëve”).
- 7.3 Regjistri i Ortakëve do të pasqyrojë informacionin e mëposhtem: (i) identitetin e çdo ortaku; (ii) numrin dhe vlerën e kuotave që i perkasin çdo ortaku; (iii) datën e fitimit të pronësisë së secilit Ortak mbi kuotat; (iv) adresën apo selinë e çdo ortaku; (v) detaje për çdo peng apo barrë të vendosur mbi kuotat.
- 7.4 Kuotat janë lirisht të transferueshme nëpërmjet trashëgimisë apo ndërmjet Ortakëve ekzistues.
- 7.5 Kalimi i të drejtave të pronesise, vënia peng, barrë apo çdo mjet tjeter sigurimi mbi kuotat do të kerkojë, në mënyrë që të prodhojë efekt, miratimin paraprak të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, e cila vendos me shumicë të thjeshte.
- 7.6 Nëse një Ortak ka për qëllim të transferojë në çdo formë të gjitha apo një pjesë të kuotave të tij një personi të ndryshem nga Ortaket deri në limitin e paketës kontrolluese të shoqërisë, secili prej Ortakeve të tjerë ka të drejten e parablerjes mbi një numër kuotash në perpjestim me pjesemarrjen e tyre në kapitalin themeltar, në varësi të faktit së sa ortakë do të ushtrojnë të drejtën e parablerjes në rastin konkret. E drejta e parablerjes ushtrohet vetëm në përputhje me procedurën në vijim.
- 7.7 Nëse një Ortak ka për qëllim të transferoje të gjitha apo një pjesë të kuotave të tij, ai, perpara së të nenshkrue marreveshje me persona të tretë të ndryshem nga Ortaket, do të njoftoje me shkrim Administratorët për transferimin e planifikuar, duke percaktuar edhe çmimin e transferimit, personin/at të cileve planifikon t'u transferoje kuotat dhe kushtet esenciale të transferimit.
- 7.8 Administratoret, brenda 10 ditëve duke filluar nga dita kur është njoftuar nga Ortaket për shitjen apo transferimin e planifikuar - do të informojnë me shkrim Ortakët e tjerë. Secili prej Ortakeve që ka të drejta parablerjeje, brenda 1 (një) muaji nga njoftimi prej Administratoreve për shitjen apo transferimin e planifikuar, do të njoftojë me shkrim Administratorët nëse ka qëllim të ushtrojë të drejtën e tij të parablerjes.
- 7.9 Administratorët brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e këtij njoftimi do të njoftojnë me shkrim Ortakun që dëshiron të transferojë kuotat e tij.
- 7.10 Nëse më shume së një Ortakë ushtrojnë të drejtat e parablerjes, ata do të blejnë këto kuota në përpjesëtim me pjesemarrjen e tyre aktuale në kapitalin themeltar.
- 7.11 Nëse asnë njoftim nuk është dhënë nga ndonjë Ortak sipas nenit 7.9 më sipër, Ortaku që ka për qëllim të transferojë kuotat e tij do të jetë i lire t'ia transferojë këto kuota personit/ave të percaktuar.
- 7.12 Nëse vetëm një Ortak ka dhënë njoftim për qëllimin e tij për të ushtruar të drejtën e parablerjes, ky Ortak do të ketë të drejtë të blejë kuotat objekt transferimi brenda 10 ditëve nga data e mbarimit të afatit të percaktuar nga nen 7.9 më sipër.
- 7.13 Çdo transferim i kuotave që nuk kryhet në përputhje me parashikimet e këtij nenit është i pavlefshëm dhe pa efekte për Shoqërinë.

7.14 Në rast të vendimit për transferimin e kuotave tek të tretet, Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë nuk do të transferojë paketën kontrolluese të aksioneve në favor të ndonjë pale të tretë, pa miratimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

NENI 8

ZMADHIMI, ZVOGELIMI DHE TRANSFERIMI I KAPITALIT

- 8.1 Kapitali themeltar mund të zmadhohet, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakeve, nëpërmjet emetimit të kuotave të reja ose rritjes së vlerës nominale të atyre ekzistuese ose në çdo forme tjeter të parashikuar nga Ligji.
- 8.2 Për çdo zmadhim kapitali të Shoqërisë nëpërmjet emetimit të kuotave të reja, Ortaket do të kenë të drejtën e parablerjes për nënshkrimin e këtyre kuotave të reja të emetuara. Nëse me shume së 1 (një) Ortak ushtrojnë të drejtat e tyre të parablerjes brenda 20 (njëzet) ditëve, atëherë ata do t'i blejnë këto kuota në përpjesëtim me pjesëmarrjen e tyre aktuale në kapitalin themeltar. Çdo kuote e re që nuk është blere nga Ortaket gjate këtij procesi, i ofrohet çdo pale të trete.
- 8.3 Kuotat e reja që do të shlyhen si me para në dore, ashtu edhe në natyre, do të paguhen në përputhje me Vendimin përkatës për zmadhimin e kapitalit dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtarë.
- 8.4 Kapitali mund të zvogëlohet, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakeve, në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtarë.
- 8.5 Transferimi i kuotave do të bëhet me shkrim, dhe në përputhje me parashikimet e Ligjit Tregtar.
- 8.6 Transferimi i kuotave kryhet lirisht mes ortakëve. Nëse një ortak dëshiron të transferojë kuotën e tij në favor të një personi të tretë, atëherë transferimi është i vlefshëm vetëm nëse hyrja e ortakut të ri të miratohet paraprakisht me shkrim nga të gjithë ortakët e tjerë Shoqërisë. Nëse ortakët e tjerë Shoqërisë nuk miratojnë transferimin e kuotës në favor të një personi të tretë brenda 5 ditësh nga data e kërkesës së ortakut që dëshiron të largohet, atëherë hyrja e ortakut të ri konsiderohet e refuzuar. Ky miratim nuk kërkonit nëse transferimi kryhet në favor të trashëgimtarëve që kanë fituar të drejta mbi pasurinë e ortakut si pasojë e trashëgimisë.
- 8.7 Në rastin kur transferimi i kuotës në favor të një personi të tretë nuk miratohet sipas paragrafit (2) më sipër, atëherë, jo më vonë së 30 ditë nga data e refuzimit, ortaku që dëshiron të largohet ka të drejtë të kërkojë që Shoqëria të zvogëlojë kapitalin, dhe t'i likuidojë kuotën, duke i paguar një shumë jo më të lartë se:
- 8.8 Vlera e kapitaleve të veta të Shoqërisë që rezulton nga pasqyrat financiare të viti finanziar që paraprin vitin financiar gjatë të cilit bëhet kërkesa për likuidimin e kuotës sipas paragrafit (3) më sipër, në raport me përqindjen e kapitalit të regjistruar që përfaqëson kuota e likuiduar; dhe
- 8.9 Vlera e fitimeve vjetore të Shoqërisë që rezulton nga pasqyrat financiare të viti finanziar gjatë të cilit bëhet kërkesa për likuidimin e kuotës sipas paragrafit (3) më sipër, në raport me përqindjen e kapitalit të regjistruar që përfaqëson kuota e likuiduar.
- 8.10 Shumat sipas paragrafit 3.1 më sipër do t'i likuidohen ortakut që kërkon të largohet, jo më vonë së 12 muaj nga data në të cilën bëhet kërkesa për likuidimin e kuotës sipas paragrafit (3) më sipër.
- 8.11 Shumat sipas paragrafit 3.2 më sipër do t'i likuidohen ortakut që kërkon të largohet, jo më vonë së 12 muaj nga data e mbylljes së vitit financiar të cilit i referohen vlera e fitimeve vjetore sipas paragrafit 3.2 më sipër.
- 8.12 Nëse Shoqëria nuk i likuidon kuotën ortakut që kërkon të largohet, në përputhje me paragrafët (3) deri në (5) të këtij nenit (edhe nëse nuk është lëshuar certifikatë e aftësisë paguese sipas nenit 9), atëherë kjo do të përbëjë shkak për prishjen e Shoqërisë dhe nisjen e procedurave të likuidimit të saj, në përputhje me parashikimet e Ligjit Tregtar.

NENI 9

- 9.1 Shoqëria vepron nën regjimin e pronës private dhe merr përsipër vetë të drejtat dhe detyrimet kontraktore dhe jashtëkontraktore. Ortakët e Shoqërisë drejtojnë procesin për zhvillimin e aktivitetit të shoqërisë si dhe për detyrimet që ka shoqëria ndaj të tretëve pa asnjë kufizim.

NENI 10 DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

- 10.1 Organet e shoqërisë jane:

- 1- Asambleja e Ortakëve.
- 2- Administratori.

NENI 11 ASAMBLEJA E ORTAKEVE

- 11.1 Organi me i lartë i shoqërisë është Asambleja e Ortakeve e cila mund të thirret nga çdo anëtar i shoqërisë që perfaqëson të paktën 5% të kapitalit të shoqërisë. Antarët duhet të njoftohen me shkresë ose nëpërmjet postës elektronike, jo me vonë se 7 ditë përparrë dhe në lajmërim duhet të jetë shkruar vendi, ora dhe çështjet e rendit të ditës që do të trajtohen në mbledhje.
- 11.2 Nëqoftëse Asambleja nuk është mbledhur sipas rregullave të caktuara, ajo mund të marrë vendim kur çdo anëtar i shoqërisë është prezent dhe janë dakort të marrin vendime pavarësisht parregullsisë.

NENI 12 TE DREJTAT DHE KOMPETENCAT E ASAMBLESE SE PERGJITHSHME TE ORTAKEVE

- 12.1 Asambleja e Përgjithshme do të jetë organi me i larte i Shoqërisë, i cili, veç kompetencave të tjera sipas Ligjit për Shoqërite Tregtare apo ketij Statuti, merr vendime për çeshtjet e me poshtme të Shoqërisë:
- a. përcaktimi i politikave tregtare;
 - b. ndryshime të Statutit;
 - c. emërimi dhe shkarkimi i Administratorëve;
 - d. emërimi dhe shkarkimi i likuiduesve dhe i eksperteve kontabël të autorizuar;
 - e. miratimi i skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat c dhe d.;
 - f. miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe i raporteve të ecurisë së veprimtarisë së Shoqërisë;
 - g. shpërndarjen e fitimeve vjetore;
 - i. zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit themeltar të Shoqërisë;
 - j. pjesëtimin dhe anulimin e kuotave;
 - k. përfaqësimin e shoqërisë në gjykime;
 - l. riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
 - m. miratimin e rregullave të zbatueshme procedurale të mbledhjeve të saj;
 - n. çështje të tjera sipas parashikimeve të këtij Statuti.
- 12.2 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mblidhet në rastet e përcaktuara nga ligjet e aplikueshme ose nga ky Statut dhe sa here që është e nevojshme për të mbrojtur interesat e Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme mblidhet të paktën një here në vit.
- 12.3 Njoftimi për thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme mund të dërgohet me shkrim apo e-mail në adresat që secili Ortak do t'i njoftoje me shkrim Shoqërisë me poste të regjistruar. Njoftimi do të konsiderohet së i është dorëzuar Shoqërisë me kalimin e ditës së 10-te pas dërgimit.
- Njoftimi për thirrjen e Asamblesë duhet të përcaktojë qartë emrin e Shoqërisë, selinë, datën, kohën dhe vendin e mbledhjes, një përshkrim të hollësishëm të procedurës që duhet të ndiqet nga Ortaket për pjesëmarrjen dhe votimin, informacion mbi vendin e mënyrën e marrjes së

dokumenteve dhe projekt-vendimeve që duhet t'u vihen në dispozicion të gjithë Ortakëve, adresën e faqes së internetit të Shoqërisë ku mund të merret informacioni, po ashtu edhe rendi i ditës, dhe duhet t'u njoftohet të gjithë Ortakëve të paktën 7 (shtatë) ditë përpara mbledhjes. Rendi i ditës i njoftuar si më sipër duhet të përbajë edhe vendimet e propozuara për çdo çështje. Nëse Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve duhet të vendosë për ndryshime të Statutit, teksti përkatës duhet të njoftohet së bashku me rendin e ditës.

- 12.4 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve do të thirret nga Administratorët dhe, kur është e zbatueshme, nga Ortaket.
- 12.5 Një Ortak mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme të Ortakëve nga një ortak tjeter apo nga një person i tretë i ndryshëm nga Administratorët, duke paraqitur dokumentin përkatës autorizues. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
- 12.6 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga Ligji Tregtar, vlefshmëria e vendimeve që përcaktojnë detyrime shtese ose kufizojnë / zvogëlojnë të drejtat që u janë njojur ortakëve nga Ligji Tregtar apo nga ky Statut, kushtëzohet nga miratimi i Ortakëve të interesuar / përkatës.
- 12.7 Të gjitha vendimet e Asamblesë duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët janë përgjegjës për mbajtjen e një kopjeje të tij.

NENI 13

MBLEDHJA E ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

- 13.1 Asambleja e Përgjithshme mblidhet sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë.
- 13.2 Mbledhja e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortaket të cilët përfaqësojnë të paktën 5% të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë.
- 13.3 Asambleja e përgjithshme thirret nëse:
 - sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
 - shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kane një vlerë më të lartë së 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
 - shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë me të larte së 5% të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

NENI 14

THIRRJA E ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

- 14.1 Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike.
- 14.2 Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- 14.3 Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur si më sipër, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsive.

NENI 15

KORUMI I NEVOJSHEM DHE VENDIM-MARRJA

- 15.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kerkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë me shumë se 30% të kuotave.
- 15.2 Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kerkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortaket që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike.
- 15.3 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumi të përmendor më sipër, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite. Asambleja e përgjithshme vendos me tre të katërtat e votave të ortakeve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 15.4 Për çështjet e tjera, Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës. Çdo kuotë jep të drejtën e një vote.
- 15.5 Ortakët, që nuk janë të pranishëm, mundësinë e pjesëmarrjes në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike.

NENI 16

PROCESVERBALI I MBLEDHJES SE ASAMBLESE

- 16.1 Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme.
- 16.2 Prosesverbal duhet të përbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalist, rezultatet e votimit. Prosesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme.
- 16.3 Prosesverbal i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalist.

NENI 17

ADMINISTRIMI

- 17.1 Asambleja e Përgjithshme emëron një ose deri në tre persona fizik si administrator të shoqërisë. Afati i emërimit, nuk mund të jetë me i gjatë së 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. në rast së gjate kësaj periudhe shfaqen probleme paaftësie nga ana e tij, Asambleja e Ortakeve vendos shkarkimin e administratorit duke treguar me fakte demin që i është shkaktuar shoqërisë nga paaftësia e tij pasi është dhënë mendimi për këtë dem edhe nga specialistet përkatës.
- 17.2 Emërimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- 17.3 Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar me të tretët në emër të shoqërisë dhe në interes të saj në të gjitha rrëthanat, me përjashtim të kompetencave që ligji dhe Statuti i shoqërisë, si më sipër, ua jep shprehimisht ortakëve.
- 17.4 Administrator i shoqërisë është:

Marina Parllaku, shtetas(e) shqiptar(e), lindur në Leskovik, Kolonjë më datë 31/03/1983, identifikuar me dokumentin kartë identiteti nr. 032615074, me numër personal I35331066W, me adresë Rruga Asim Vokshi, Nd.14, H.52, Ap.36, Njesia Administrative Nr. 9, 1058, Tiranë, Shqipëri;

NENI 18

- 18.1 Administratori ka liri të plotë për drejtimin e zakonshëm të shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha llojet e veprimeve dhe çdo lloj marrëveshje për realizimin e qëllimeve të shoqërisë duke përjashtuar rastet që janë të parashikuara në ligj dhe në Statut që i takojnë Asamblesë së Ortakëve.

NENI 19

- 19.1 Administratori ka të drejte të nënshkruajë kontrata të ndryshme përfurnizime publike private, të ndërmarrë veprime gjyqësore përfundimtare dhe në emër të shoqërisë, etj. Administratori mund të japë prokura në kufijtë që i lejon Asambleja e Ortakëve përkategoritë caktuara veprimesh. Përfaqësimi ligor i shoqërisë është i vlefshëm përfundimtare apo jashtëgjyqësor.
- 19.2 Administratori është i detyruar të mbaje konform ligjit të gjitha registrat e domosdoshme përkaktivitetin e shoqërisë. Administratori i shoqërisë është i detyruar të mbaje inventare të rregullta. Raporti i administrimit, inventari dhe llogarite vjetore, hartohen nga Administratori.
- 19.3 Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë përfundimtare apo çdo veprim apo mosveprim që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur në baze të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse veprimi apo mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- 19.4 Administratori është përgjegjës përfundimtare e shoqërisë dhe informon ortaket përfundimtare e veprimtarisë tregtare të shoqërisë. Gjate veprimtarisë së tij ai vepron duke marre parasysh interesat e shoqërisë, duke zbatuar parimet e detyrimit të besnikërisë.

NENI 20

MARREDHENIET E PUNES

- 20.1 Marrëdhëniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratës së punës dhe legjislacionit të punës në fuqi. Shoqëria private merr përsipër të respektoje rregullat në fuqi të punësimit dhe të punësuarit janë të detyruar që të respektojnë Statutin e kësaj shoqërie dhe rregullat e brendshme të saj. Të punësuarit duhet të përgjigjen përfundimtare që i shkaktojnë kësaj shoqërie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

NENI 21

KONFIDENCIALITETI, RUAJTJA E SEKRETIT

- 21.1 Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet të behet publike përbajtja e tyre përfundimtare e të gjitha akteve dhe dokumenteve që janë përcaktuar si të tilla nga administratori i kësaj shoqërie.

NENI 22

EKSPERTET OSE REVIZORET KONTABEL

- 22.1 Kontrolli mbi veprimtarinë e Administratorit, veprimtarinë e tij si dhe gjithë aktivitetin e shoqërisë i besohet një eksperti ose revizori kontabël. Ky ekspert do të qëndrojë në detyre përfundimtare që sa përcaktohet me ligj dhe mund të rizgjidhet. Asambleja e Ortakëve cakton dhe shpërblimin përkatës kur nuk ka norma të veçanta ligjore.

NENI 23

BILANCI DHE NDARJA E FITIMEVE

- 23.1 Veprimtaria ekonomike e shoqërisë do të mbylljet në ditën 31 Dhjetor të çdo viti. Administratori merr masa përfundimtare e bilancit dhe rezultatin ekonomik fitim - humbje dhe inventar. Pasi veçohen fondet si më sipër dhe paguhen detyrimet fiskale, të ardhurat që mbeten ndahen midis ortakëve dhe mund të transferohen lirisht jashtë shtetit sipas dispozitave përkatëse ligjore.
- 23.2 Shoqëria mund t'u shpërndajë ortakëve fitimet e vjetore sipas pasqyrave financiare, vetëm nëse pas pagimit:
- 23.3 aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;

- 23.4 shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.
- 23.5 Administratorët lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht së shpërndarja e propozuar e dividendëve përbush kërkeshat e pikës 1 të këtij nenit, ndërsa kur gjendja e Shoqërisë tregon së shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përbush këto kriteret, administratorët nuk mund ta lëshojnë këtë certifikatë.

NENI 24

SHPERNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

- 24.1 Shoqëria prishet (i) me vendim të Asamblesë së Pergjithshme të Ortakeve; ose (ii) në rast falimentimi; ose (iii) kur Shoqëria nuk ka kryer veprimtari për 2 (dy) vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimitarës në QKR; ose (iv) me vendim gjykate; ose (v) për arsyet tjerat të parashikuara në ligj.
- 24.2 Prishja e shoqërisë regjistrohet në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit nga Administratorët.
- 24.3 Prishja e shoqërive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedure falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Asambleja e Përgjithshme. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.
- 24.4 Çdo person i interesuar, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës zëvendësimin e likuiduesit, sipas vendimit të ortakëve, nëse paraqet arsyet mjaftueshme për të dyshuar së likuidimi i rregullt i shoqërisë mund të cenohet nga likuiduesit e emëruar si me sipër. Kërkesa duhet të depozitohet në gjykate brenda 30 ditëve nga data e caktimit të likuiduesit.
- 24.5 Gjykata emëron likuiduesin, në rastet kur shoqëria tregtare prishet me vendim gjykate. Likuiduesit shkarkohen dhe zëvendësohen me të njëjtat kushte, të parashikuara në dispozitat për emërimin e tyre.
- 24.6 Administratorët e shoqërisë i njoftojnë për regjistrim, Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të dhënët e likuiduesve të pare dhe tagrat e tyre, për të përfaqësuar Shoqërinë, së bashku me dokumentet përkatëse. Likuiduesit depozitojnë nënshkrimin e tyre.
- 24.7 Likuiduesit i njoftojnë, gjithashtu, Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim çdo ndryshim për identitetin dhe tagrat e tyre të përfaqësimit. Emërimi i likuiduesve nga gjykata regjistrohet ex officio, sipas nenit 45 të ligjit nr. 9723, date 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".
- 24.8 Likuiduesit duhet të ftojnë kreditoret e shoqërisë për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj. Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratoreve nga data e emërimit të tij.

NENI 25

TE DREJTAT E DETYRIMET E LIKUIDUESIT

- 25.1 Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të pa arkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditoreve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.
- 25.2 Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

NENI 26
LIBRAT E SHOQERISE

- 26.1 Po kështu shoqëria në bazë të ligjit mban librat e mëposhtëm:
- Libri i Ortakeve
 - Libri i Mbledhjeve
 - Libri i vendimeve të organit administrativ
 - Libri i mbledhjeve dhe vendimeve të eksperteve ose revizoreve kontabël.
- 26.2 Librat e mësipërm duhet të jenë të ruajtura për 10 vjet e çdo faqe duhet të jetë e vulosur.

NENI 27
SHPERNDARJA E AKTIVEVE

- 27.1 Pas shlyerjes së detyrimeve ndaj kreditorëve, likuiduesi u shpërndan ortakëve apo aksionarëve aktivet e mbetura, sipas të drejtave që ata kanë në ndarjen e fitimeve, me përjashtim të rastit kur statuti parashikon radhë preference.
- 27.2 Pasuritë, që i janë dhënë shoqërisë me qira apo në përdorim, me çfarëdo titulli, u kthehen ortakëve apo aksionarëve.
- 27.3 Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë.

NENI 28
DISPOZITA TE PERGJITHSHME

- 28.1 Për sa është shprehur në këtë statut i referohemi ligjit 9901 dt. 14.04.2008 "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", dhe rregullores së brendshme të shoqërisë. Çdo ndryshim behet në të njëjtën mënyrë siç është nxjerre ky Statut dhe nuk prek personalitetin juridik të kësaj shoqërie.
- 28.2 Ky Statut hyn në fuqi pas miratimit dhe regjistrimit të Shoqërisë në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
- 28.3 Gjithçka nuk është parashikuar shprehimi shtetësuar në këtë Statut do të rregullohet nga legislacioni tregtar dhe ligje të tjera të lidhura me të në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
- 28.4 Ky Statut përpilohet në 4 (katër) kopje në gjuhën shqip dhe anglisht me të njëjtën vlerë, dhe nënshkruhet pa vërejtje nga ortakët themelues.

ORTAKET E SHOQERISE
Compelling Works SHPK



MARINA PARLLAKU



SIMON PETER NDIRA